Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Zyra e Drejtorit/ Kancelarija Direktora /Office of the Director

Numër: 02 - 589
Datë: 31.10.2018

Bazuar Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, Rregullores Nr. 09/2012, për Standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën shtetërore, Rregullores nr. 05/2012, për Klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil si dhe në Rregulloren nr.03/2010, për Përshkrimet e detyrave të punës, drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) nxjerr:

V E N D I M

1. Për themelimin e Grupit punues për hartimin e projektrregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

2. Grupi punues ka për detyrë që në kuadër të përgjegjësive që rrjedhin nga ky vendim ta filloj punën për draftimin e Projektrregullores në fjalë.

3. Anëtarë të grupit punues janë:

1.	Milot Hasangjekaj	koordinator	AKK
2.	Anita Rukovci	anëtar	AKK
3.	Bleta Kadriu	anëtar	AKK
4.	Donjeta Nimani Binçe	anëtar	AKK
5.	Kaltrina Mulliqi	anëtar	AKK
6.	Avni Gashi	anëtar	AKA
7.	Elhame Shabani	anëtar	MASHT
8.	Minire Gashi	anëtar	MASHT
9.	Rrahman Zahiti	anëtar	MAP
10.	Arife Kodraliu	anëtar	MAP

4. Vendimi hynë në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitiv të këtij vendimi dhe nevojën për hartimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Anëtarëve të grupit punues;
2. Zyrës së drejtorit;
3. Arkivit të AKK.

Lah Nitaj
Drejtor i AKK
.....